



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverballi i mbajtur më 27 maj 2014, në mbledhjen e V-të(pestë) të Kuvendit.

Mbledhja filloi në orën 10:25 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z. Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm drejtorët e Drejtorive komunale, z. Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, të nderuar këshilltarë të Kuvendit, para vetës keni një propozim vendim të cilin posa e morët i cili ka të bëjë me dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, pra fjala është për parcelën me numër 502, zona kadastrale Sallabajë, pronë për të cilën kemi persona të interesuar ndër të cilët është lajmëruar edhe një donator potencial i cili së bashku me një person të nacionalitetit Gjerman dëshirojnë të ndërtojnë një banjë në pronën e cekur. Prona në fjalë është e rrethuar nga pronat private në të cilat donatori përkatës ka planifikuar të ndërtoj objektin ndërsa pronën komunale mendon të shfrytëzoj si hapësirë ambientale, kështu që kërkoj nga ju të keni mirëkuptim në mënyrë që këtij individ t'ia mundësojmë, gjithnjë duke respektuar legjislacionin që e rregullon këtë çështje, dhënien e asaj prone në shfrytëzim afatshkurtër.

z. Naim Çunaku, theksoi, nga ajo që e propozoi drejtori parafolës, del që me kërkesën e një afaristi apo siç u tha investuesi potencial, kërkohet që të jepet në shfrytëzim prona komunale. Unë konsideroj se ai person mund të jetë vetëm një nga konkurrentët sepse kriteret e dhënies së pronave komunale në shfrytëzim janë të përcaktuara shumë mirë me Ligjin përkatës, pra nëpërmes shpalljes publike, me ankand, mirëpo ne të japim pronën komunale në shfrytëzim një personi i cili ka shpreh gatishmëri të marr atë pronë komunale në shfrytëzim pa i përfillur procedurat e parapara me ligj, mendoj se është një defekt. Lidhur me këtë çështje, mendoj se nuk është aq e ngutshme dhënia në shfrytëzim e një prone komunale, pa i respektuar procedurat ligjore, duke përfshirë, afatet ligjore, të kaloj nëpërmes Komitetit për Politikë dhe Financa, të shpallet si aset të cilin Komuna dëshiron të jap në shfrytëzim, pastaj me procedura të mëtutjeshme të jetë ai person i cili ka konkurruar, përzgjedhës, por nëse i ofron kushtet më të mira.

z. Haki Rudari, theksoi, një ditë më parë në Komitetin për Politikë dhe Financa, kamë propozuar një pikë të rendit të ditës e cila nuk është përfshirë në konstatime – rekomandime, andaj dëshiroj të paraqes prapë sot këtu para jush dhe do të kërkojë përkrahjen tuaj. Një ndër pikat e rendit të ditës për këtë mbledhje do të debatohet për vërshimet, dhe unë dje në KPF kam kërkuar që të kemi një raport ose një pikë të rendit të ditës në lidhje me bujqësinë, andaj nëse sot nuk është e mundshme kërkoj që ky Kuvend t'i rekomandon Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që në mbledhjen e ardhshme në kuadër të rendit të ditës të përfshihet edhe një raport nga ajo Drejtoria për të mbjellat pranverore dhe subvencionet e ndryshme, nuk jemi kundër subvencioneve por në parim duhet të jemi në dijeni se çfarë subvencioneesh janë duke u ndarë, kujt po i ndahen ato si dhe duhet të jemi në dijeni se si ka shkuar fushata e mbjelljeve pranverore. Pra edhe një herë, duke parë se kjo kërkesë nuk është përfshirë në konstatime të Komiteti për Politikë dhe Financa i mbajtur më 26.05.2014, kërkoj sot në Kuvend që ky propozim të merret parasysht.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, konsideroj se nuk ka arsyeshmëri të mjaftueshme propozimi të cilin e bëri z. Abaz Llughaliu, sepse t'i japësh dikujt një pronë komunale në shfrytëzim duke e ditur se çka do të investohet dhe duke e ditur vlerën e investimeve, mendoj se nuk është në rregull, dhe përveç kësaj mendoj se ajo që e tha z. Naim Çunaku është shumë e qëndrueshme ngase nuk mund t'i japim ndokujt pronën pa iu nënshtruar konkurrencës, dhe se fundja prona është aset nga e cila Komuna ka interes prej saj.

z. Abaz Llughaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, paraprakisht kërkoja një mirëkuptim ngase nuk kemi mundur të përgatitim këtë propozim për të kaluar përmes Komitetit për Politikë dhe Financa, ndërsa nëse ndokush dyshon se dhënie e asaj prone nuk do të kalon nëpër filtrat ligjore gjegjësisht të konkurrencës, unë e siguroj se ajo çështje nuk vie në diskutim, sepse vetë fakti që e kemi paraqitur në Kuvend nënkupton që jemi për t'i respektuar të gjitha rregullat ligjore, gjithashtu ne kemi të ngritur komisionin për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim në të cilin bëjnë pjesë edhe këshilltarë të Kuvendit, kështu që sigurisht se do të respektohet ligji sepse ne absolutisht nuk i kemi premtuar askujt, por unë vetëm theksova që ka të interesuar për atë pronë dhe përmenda vetëm një nga ata të interesuar i cili parashikon të investoj rreth 20,000,000,00 € (njëzet milion). Pra nëse merret vendim këtu në Kuvend, automatikisht menjëherë do të fillohet me procedim ashtu siç e parasheh ligji, duke e shpallur një muaj në veb faqe të Komunës në mënyrë që t'ju mundësohet aplikimi të interesuarve, dhe pastaj komisioni përkatës do të bënë përzgjedhjen e atij që është më i favorshmi.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, ne e kuptuam dëshirën e drejtorit për t'ia dhënë atë pronë komunale në shfrytëzim personit të caktuar, mirëpo ajo çka deklaroi drejtoria këtu, nuk mundet Kuvendi të miraton vendim për dhënien e pronës prej 30 ha një personi, kurse nuk dihet se kush do të jenë konkurrentët tjerë. Dëshiroj të përmendi që për çështje të ngjashme ka shumë persona të cilët janë në procedura penale siç është edhe rasti i kryetarit të komunës së Prizrenit i cili një investitor i ka dhënë pronë komunale në shfrytëzim pa i përfillur procedurat ligjore, andaj ne jemi për të sjellur investime dhe për të përkrahur bizneset në Komunën tonë, por drejtoria përkatës me propozim të Kryetarit të Komunës, bënë kërkesë këtu në Kuvend që të miratohet ky propozim dhe t'i jepet prona përkatëse në shfrytëzim personit të caktuar, e që prona përkatëse së pari është dashur të del në ankand publik, është dashur gjithashtu të kemi në rend dite në Komitet për Politikë dhe Financa, e them këtë sepse, në qoftë se ai investitor është në gjendje të investoi

20,000,000,00 € (njëzet milion), i ka kryer të gjitha përgatitjet ndërsa në anën tjetër nuk është në gjendje të bënë kërkesë me kohë. Mendoj se do të ishte mirë që së pari të del prona përkatëse në ankand publik dhe të shikohet se a është ajo pronë për t'u dhënë në shfrytëzim, të kalon përmes KPF-së e pastaj të vie në Kuvend për miratim.

z. Naim Çunaku, theksoi, gjithë herë e kemi thënë që ne jemi për çdo investim që bëhet në Komunën tonë gjithnjë duke e qenë në dijeni se rritet punësimi, zhvillimi dhe mirëqenia e qytetarëve, mirëpo aty ku konteston ajo që unë e thashë, është se duhet të respektohen procedurat, e them këtë ngase qysh në start të këtij propozimi bëhet shkelje sepse nuk kalon në Komitet për Politikë dhe Financa dhe nën dy mendoj që ky Kuvend një herë e mirë duhet t'i ketë regjistrin e të gjitha pronave komunale dhe të merr vendim që të gjitha ato prona komunale të jenë në disponim të investitorëve, kudo qofshin ato, dhe jemi për këtë, por ashtu siç drejtori propozoi, del që kemi një investues, andaj për ata edhe propozohet kjo me qëllim të krijimit të të hyrave vetanake, në vend që të dalin pronat njëherë e pastaj të kemi investues, ne gjithëherë e kemi mbështetur inkasimin e të hyrave vetanake për projekte zhvillimore të Komunës, por jo nëse ndokujt i bie ndërmend për një pronë në momentin që paraqitet ndonjë investitor. Pra paraprakisht ky Kuvend duhet t'i ketë incizimet e të gjitha pronave dhe të merr vendim që i lejon gjegjësisht i ka në treg të gjitha asetet e Komunës për kohë të caktuar, nëse ka për qëllim të krijoj të hyra vetanake, ndërsa të kalon pa përfillur procedurat ligjore të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe pa lënë kohën të mjaftueshme që të jetë në disponim të këshilltarëve për të menduar, unë do të jem kundër.

z. Kadri Avdiu, theksoi, mendoj se nuk duhet të bëhen polemika shumë rreth kësaj, nga ajo që e tha drejtori i cili e prezantoi se kjo çështje është e ngutshme sepse kemi një investitor, kurse ne kemi qe katër muaj mjete të ndara për Obeliskun Afrim Zhitia çështje në të cilën pushteti lokal është dashur të punoj me një kohë krejt tjetër, dua të them se për këtë propozim po u mundka të shkelen të gjitha procedurat ndërsa për pronën te Obelisku nuk po u mundka mu tjetërsuar ajo pronë e cila është e Komunës. Nuk e mbështeti asnjë propozim i cili është në kundërshtim me ligjin, por konsideroj se duhet të veprohet sipas fazave, e jo vetëm të arsyetohet nga drejtori se nuk ka qenë Kryetari i Komunës dy tri ditët e fundit dhe nuk ka mundur të procedohet ky propozim më herët, pra ne jemi që të përfillen të gjitha procedurat për të gjitha pronat njëjtë, e jo të ketë ndokund bllokada e ndokund mos përfillje të procedurave nëpërmes metodave të juaja.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, fillimisht e njoftoj z. Haki Rudarin që për propozimin të cilin e ka bërë në Komitet për Politikë dhe Financa unë në formë gojore ia kam përcjell drejtorit përkatës dhe drejtori e ka marr përsipër që në mbledhjen e radhës do të përgatit një informatë.

Nga Ekzekutivi i Komunës gjegjësisht Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë kemi një propozim për përfshirje në rend dite për këtë mbledhje, dhe unë në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit pajtohem se duhet të respektohen ligjet, por dëshiroj të theksoj se sot kemi të bëjmë vetëm me marrjen e vendimit e kurrësesi të anashkalohen procedurat tjera ligjore, gjithashtu jeni në dijeni se për këto çështje kemi të ngritur dhe një komision nëpërmes të cilit do të kaloj, mandej është ankandi publik, konsultimi i nevojshëm me organet qendrore. E kemi theksuar edhe më parë se kur kemi të bëjmë me përkrahje të bizneseve është mirë që të përgatiten të gjitha ato prona të cilat janë të lira për marrjen e vendimeve, por në rend të parë duhet të respektohet ligji. Ne sot kemi një propozim për futje në rend dite për debat, jam në dijeni se ky vendim nuk ka kaluar

përmes Komitetit për Politikë dhe Financa, organ i cili nuk merr vendime por vetëm i rekomandon Kuvendit, dhe Kuvendi është ai që merr vendim dhe nëse kalon, mirë nëse jo atëherë kthehet mbrapa.

z. Haki Rudari, theksoi, duke e parë rrjedhën e debatit, ne mendojmë që ky propozim të cilin e paraqiti drejtori i DPKGJ, duhet të kalon përmes Komitetit për Politikë dhe Financa në mbledhjen e radhës, andaj ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së jemi kundër që ky propozim të futet si pikë e rendit të ditës në këtë mbledhje, për arsye se nuk ka kaluar përmes KPF-së, dhe sigurisht se nëse do të hyn në këtë mbledhje ne do të votojmë kundër.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë e patëm një propozim konkret unë e hedhë në votim për përfshirje në këtë rend dite, propozim vendimin për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, në parim, sepse mund të mos kuptohemi drejtë, nuk duhet të jemi asnjë kundër njerëzve të cilët kanë interesime për investime për Komunën tonë, përkundër ne duhet t'i mbështetim fuqishëm dhe duhet të bëjmë gjithçka që investime të sjellim sa më shumë. Mua propozimi i drejtorit më bëri përshtypje që këtu bëhet fjalë për një investitor të paracaktuar, dhe si të tillë unë mendoj se nuk është në rregull, mirëpo si prona të cilat mund t'i jepen dikujt në shfrytëzim për një kohë të caktuar dhe investime të caktuara është krejt në rregull për mua, por nga ajo që unë kuptova deri më tani është që ne po japim në shfrytëzim atë pronë sot, me vendim, por nëse veprohet konform procedurave që prona t'i nënshtrohen konkurrencës, atëherë për mua është në rregull.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, gjithashtu edhe unë mendoj se duhet të veprohet në bazë të ligjit duke mos përcaktuar personat e interesuar për atë pronë sepse janë procedurat ligjore të cilat e rregullojnë shumë qartë këtë çështje, pra kemi të bëjmë me komisionin përkatës, konkurrencën e lirë e të tjera.

Pas votimit u konstatua se me 18 vota për, 14 vota kundër dhe 1 votë të përmbajtur miratohet rendi i propozuar i ditës duke u përfshirë edhe pika;

❖ **Propozimi i Vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurt të pronës së paluajtshme të Komunës**

(z. Naim Çunaku, kërkoi që të konstatohet në procesverbal se Grupi i këshilltarëve të PDK-së edhe pse votoi kundër, nuk është kundër dhënies së pronës në shfrytëzim, por është kundër mospërfilljes së procedurave të Kuvendit)

2. Informatë për vërshimet, aktivitetet e ndërmarra si dhe dëmet e shkaktuara nga vërshimet në periudhën prill – maj 2014

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Kadri Avdiu, theksoi, drejtori e paraqiti një informatë rreth gjendjes faktike që ka qenë në terren, mirëpo vërejtjen që e kamë bërë në Komitet për Politikë dhe Financa do të paraqesë edhe në këtë mbledhje të Kuvendit, jemi në dijeni se në territorin e Komunës tonë e veçanërisht në disa lokacione që kanë ndodhur vërshimet ka qenë një situatë e jashtëzakonshme, andaj unë konsideroj se Kryesuesi i Kuvendit është dashur të thërret

një mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit, gjë për të cilën konsiston kjo vërejtje, dhe mendoj se ky është një lëshim i cili ka ndodhur edhe para dy viteve dhe i cili përsëritet prapë, fjala është kur ka rënë borë e madhe. Parafolësi e potencoj se kanë qenë në aksion Policia, Zjarrfikësit, Ekipet mobile etj, por unë them se organi më i lartë i Komunës, që është Kuvendi, nuk ka qenë i mbledhur e që mendoj se ka qenë dashur të mblidhet sepse ka qenë një gjendje vërtetë e jashtëzakonshme dhe është dashur të ndahen obligimet dhe përgjegjësit ngase ne jemi përgjegjës për këtë.

Sa i përket konstatimit që është bërë, se ka pasur reshje dy deri në tri javë pa ndërprerë, është plotësisht e vërtetë, mirëpo për dëmet që janë shkaktuar është fajtores Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit së bashku me qeverisjen komunale e cila nuk i ka marrë masat me kohë për zgjerimin e lumenjve dhe vendosjen e tyre në hapësirën kadastrale të tyre, e them këtë sepse ne jemi në dijeni se aty ku është intervenuar në zgjerimin e lumenjve, e që ka shumë pak intervenime nga ana e Komunës në zgjerim të lumenjve, nuk kemi shkaktim të dëmeve, me këtë dua të them se qeverisja komunale patjetër duhet të intervenoi në këtë Drejtori dhe njëherë e mirë të marrë vendime në mënyrë që të mos të na përsëriten më këto dëme, sepse shumë më lirë kushton zgjerimi i lumenjve dhe pastrimi i tyre nga mbeturinat e ndryshme, për të cilat Drejtoria e Inspeksionit as njëherë deri më tani nuk ka ndërmarrë kurrfarë masash ndaj keqbërësve, se dëmet të cilat shkaktohen sa herë që kemi këso lloj gjendjesh. Pra nëse do të ishte intervenuar vetëm nga një apo dy km për vit që 14 vite pas luftës, ne sot do të ishim në përfundim të rregullimit të kësaj çështjeje dhe dëmet nuk do të ishin kaq të mëdha, si në bujqësi, infrastrukturë po ashtu edhe dëme të shtëpive dhe pronave tjera familjare. Më vjen mirë që në këtë raport është konstatuar edhe gjendja e një familjeje shtatë anëtarësh të cilës ju ka rrezikuar jeta e tyre nga dëmi që i'u është bërë në shtëpinë e tyre e cila i'u ka mbetë pabanuar.

Pra vërejtjet e mia janë, që në të ardhmen të ndahen më shumë mjete buxhetore dhe të merret si prioritet ky problem sepse ne nuk jemi në dijeni se në të ardhmen a do të kemi apo jo reshje të atij intensiteti, dhe për një gjë i gëzohem faktit që Liqeni i Batllavës ka qenë i shterur se për ndryshe do të ishte një katastrofë e përmasave të mëdha, kështu që unë sugjeroj që të bëhet zgjerimi, pastrimi dhe rregullimi i lumenjve. Gjithashtu Rregulloren përkatëse e kemi miratuar në Kuvend për gjobitjen e atyre personave të cilët hedhin mbeturin apo në çfarëdo forme bëjnë degradimin e lumenjve në territorin e Komunës tonë, gjë e cila do të bënte që shteti përkatësisht komuna jonë të funksionoj, e them këtë ngase kur qytetarët shohin se qeverisja lokale nuk është duke funksionuar atëherë ata mund ta bëjnë uzurpimin e pronave afër lumenjve, ngushtimin e tyre, hedhjen e mbeturinave në lumenj e të tjera.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, vlen të vlerësohet angazhimi i Kryetarit të Komunës z. Agim Velu dhe gjithë Ekzekutivit të Komunës së Podujevës për angazhimin e madh që e kanë pasur gjatë kësaj periudhe për të cilën është duke u debatuar. Mendoj se në degradimin e lumenjve është edhe faktori njeri ku kemi raste të hedhjes së mbeturinave në lumenj dhe ndërtimit të objekteve të ndryshme afër tyre e që ndikon drejtpërdrejt në ngushtimin e shtratit të tyre, mirëpo Komuna e Podujevës është duke vazhduar projektin për zgjerimin e lumenjve duke përfshirë edhe Lumin Llap. Pra nuk dëshiroj të zgjati shumë, sepse të gjitha i tha drejtori në fjalën hyrëse, por konsideroj se është mirë që çdo herë e më shumë duhet të jemi të angazhuar dhe më aktiv për mbrojtjen e lumenjve.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, në fakt ato ditë gjatë së cilave ndodhën vërshimet ishin jashtëzakonisht të rënda, sa për informacion të kolegëve, unë i'u kam drejtuar me një kërkesë zyrtare Kryesuesit të Kuvendit, shefave të Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit z.Islam Revuçit, z.Kadri Avdiut, z.Haki Rudarit, për të thirrur një mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit që së paku ne të bashkë ndjejmë gjendjen e rëndë me bashkëqytetarët tanë të cilët ishin të rrezikuar, në atë kërkesë kam bërë edhe dy propozime, njëri ka qenë, të ngritet një komision për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet, dhe propozimi i dytë ka qenë që ne si Kuvend t'i drejtohem me kërkesë Qeverisë së Republikës së Kosovës për kompensim të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet, mirëpo e vërteta është se vullneti politik ka munguar edhe nga ana e LDK-së dhe nga ana e PDK-së sepse këto dy Grupe të këshilltarëve kanë mundur të thërrasin një mbledhje të jashtëzakonshme ngase i kanë numrat e mjaftueshëm, por kjo nuk ka ndodhur. z. Kadri Avdiu në diskutimin e tij pak më parë konstatoi disa çështje, ku një ndër to ishte edhe ngushtimi i shtratit të lumenjve, konsideroj se duhet të diskutojmë për këto çështje, edhe në kohë të çeta dhe në mbledhje të ndryshme, e jo vetëm atëherë kur të paraqitet nevoja për diskutim apo kur të kemi vërshime, të debatojmë për probleme të ndryshme në takime të ndryshme, në mënyrë që këso gjërash të mos na ndodhin në të ardhmen.

z. Haki Rudari, theksoi, është e vërtetë ajo që e tha parafolësi që ka bërë kërkesë për thirrjen e një mbledhje të jashtëzakonshme dhe është e vërtetë se ne i kemi kthyer përgjigje pozitive, që do të thotë se kemi qenë për thirrje të një mbledhjeje të jashtëzakonshme të Kuvendit. Realisht për atë gjendje të krijuar nga vërshimet nuk mund të fajësohet faktori njeri, por duhet të fajësohet Qeveria e Kosovës dhe Ekzekutivi i Komunës për disa gjëra, ndërlidhem me këtë sepse unë personalisht bashkë me kolegë të Grupit të Këshilltarëve dhe kolegë tjerë nga subjekti politikë të cilit i takoj kemi vizituar ato ditë disa vende ku ka pasur vërshime ku kemi parë një gjendje me të vërtetë të mjerueshme duke filluar nga fshati Repë e poshtë, kemi vizituar edhe fshatra tjera të prekura nga vërshimet si, Siboc, Lupç, Sekiraqë, Surkish e të tjera. Unë edhe në mbledhjen e KPF-së kam bërë vërejte dhe kam kërkuar informata më të hollësishme se si është bërë verifikimi i dëmeve në terren, sepse në raport thuhet, komisioni ka bërë verifikimin e gjendjes në terren, unë pyes si është bërë kjo, sepse ne kemi vizituar familje, lagje dhe fshatra të prekura nga vërshimet të cilat edhe i kemi pyetur se a i'u ka vizituar ndokush nga pushteti lokal, e për këtë na është thënë askush nga ana e Komunës nuk ka bërë vizita, pastaj e vëreja një shumë 162,914.00 € që i referohet dëmeve në bujqësi, por më intereson të di se sa hektarë tokë bujqësore janë dëmtuar nga këto vërshime, e kërkoj këtë ngase ajo që unë kërkoja më herët nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka korrelacionet që ndërlidhen me këtë që sapo e kërkoja për arsye se po të kishim dalë në terren do të ishim saktësisht në dijeni se sa hektarë tokë bujqësore janë dëmtuar. Nga disa parafolës u tha se fajtorë janë qytetarët gjë për të cilën në një mënyrë pajtohem mirëpo konsideroj se fajtorë kryesorë është Ekzekutivi i Komunës, gjithashtu pajtohem që një mbledhje të radhës të debatohet për ambientin sepse kudo që shkohet në territorin e Komunës tonë vërehet një papastërti e madhe si afër shkollave, afër lumenjve e kudo tjetër, prandaj nuk është mirë që njëherë t'i presim vërshimet e pastaj të debatojmë për atë çështje.

Pra përveç vërshimeve që kanë ndodh, në këtë rast ka dështuar faktori njeri e posaçërisht sa kam vërejtur unë Ekzekutivi i Komunës ka dështuar në vizitat në terren.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, shihet se dëmet nga vërshimet janë jashtëzakonisht të larta dhe nuk dëshiroj të merrem me të kaluarën por sugjeroj që të bëhen investime në zgjerimin e shtretërve të lumenjve dhe besoj se edhe dy apo tri vërshime nëse do të ketë, shtretërit e lumenjve do të zgjerohen dhe nuk do të kemi më dëme kaq të mëdha.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, mendoj se Drejtoria në përgjithësi e ka përshkruar raportin dhe se ne e kuptojmë se kjo gjendje ka qenë reale, mirëpo ndoshta mund të ketë dëme edhe më të mëdha se ato që janë përshkruar në raport. **z. Fidan Rekalu** e lavdëroj Kryetarin e Komunës për angazhimin e tij gjatë periudhës së vërshimeve, por unë mendoj se po të ishte mandati i parë i tij, pesë mujori i qeverisjes së Komunës nga ai, atëherë do të thoshim se po, ka dal në vend të ngjarjes, është angazhuar etj, por është mandati i dytë i tij dhe gjendja në ato pjesë ku ka pasur vërshime është e njëjtë, mirëpo ne e kemi raportin e Drejtorisë përkatëse ku vetë kjo Drejtori dhe raporti dhe raporti që ka bërë paraqesin një mos efikasitet të inspektorëve komunal. Sa i përket asaj që u bënë disa vërejtje për mos thirrjen e një mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit konsideroj se është përgjegjësi e Kryesuesit të Kuvendit në radhë të parë e pastaj edhe përgjegjësi e jona si këshilltarë të Kuvendit kështu që tani neve na bie të merremi me Ekzekutivin e Komunës sepse nëse ne do të ishim në terren si Kuvend sigurisht se do të ndanim përgjegjësit.

Është mandati i dytë radhazi i Kryetarit Velu, me gjitha ato angazhime që ka bërë për të cilat është në dijeni ai vetë dhe janë në dijeni të gjithë qytetarët, dhe e kuptoj vështirësinë e drejtorëve të Drejtorive përkatëse për një menaxhim të tillë sepse pa pasur një përkrahje të Kryetarit të Komunës dhe pa pasur një përkrahje të inspektorëve komunale puna e Drejtorive nuk mund të del mirë dhe pa një buxhet të mjaftueshëm dhe pa pasur një plan të miratuar për rrezikshmëri cila nuk është paraparë nga Kryetari as në planin e KKSB-së për të cilën do të debatojmë në këtë mbledhje andaj Drejtorit përkatëse duke u përfshirë edhe Policia dhe Zjarrfikësit e kanë pasur të vështirë të menaxhojnë këtë situatë ngase ka munguar Plani përkatës në të cilin po ashtu nuk është paraparë rrezikshmëria e forcës madhore gjë për të cilën mendoj se vërshimet janë madje edhe rrezik global ndërsa Kryetari i Komunës nuk e ka paraparë këtë në Planin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi i cili është dashur që në fillim të vitit të jetë si pikë e rendit të ditës për miratim gjë që do të na kishte mundësuar t'i bëjmë vërejtjet tona për gjendjen e lumenjve andaj kërkoj që në të ardhmen Kuvendi i Komunës dhe Ekzekutivi i Komunës të parashohin këto situata si me buxhet ashtu edhe me Plan sepse ne jemi në dijeni për gjendjen e lumenjve në territorin e Komunës së Podujevës dhe për të cilën kemi debatuar edhe kur kemi pasur para vetës raportin financiar për vitin 2013 në të cilin ka pasur një shumë të konsiderueshme të ndarjes së buxhetit për një kompani e cila merret me këtë çështje. Kështu që mendoj se drejtori e ka paraqitë raportin e dëmeve nga vërshimet ku parashihen gati gjysmë milioni dëme, por konsideroj se e ka të vështirë të menaxhoj situata të tilla për shumë arsye, kështu që e lus Kryetarin e Komunës që të bëjë ndarjen e buxhetit edhe për situata të tilla në mënyrë që të mos vijmë në një situatë fare kemi ardhur me dëme të mëdha, siç është rasti i familjes me tetë anëtar e cila ka mbetur pa shtëpi banimi.

z. Naim Çunaku, theksoi, situata të cilën e patëm nga vërshimet ka shkuar dhe nuk mund të kthehet mbrapa por kisha dashur të nxjerrim mësim nga ajo dhe në të ardhmen të merremi më shumë me preventiv se sa të merremi me pasoja siç jemi duke u marrë. Ne patëm disa vërejtje në spikamë që një prej faktorëve kryesorë që ka ardhur deri te një situatë e tillë është qytetari por unë them se shiun dhe të reshurat nuk i bie qytetari dhe nuk mund të jetë fajtor ai dhe se fatkeqësitë elementare mund të ndodhin në tërë rruzullin tokësor dhe s'mund t'i përjashtojmë as në Komunën tonë por pushteti është ai i cili mund të merr preventiva që të mos ndodh apo të paktën ta minimizoj dëmin nga ajo që mund të ndodh. Ne tani jemi duke diskutuar për aktivitete gjegjësisht për një informatë të Drejtorisë përkatëse, pa dashur të specifikoj se kjo Drejtori është ajo e cila do të duhej të bënte mrekulli apo përmirësimin që të mos ndodh ajo që ka ndodhur mirëpo për një situatë të jashtëzakonshme siç e kemi pasur duhet të kemi edhe një angazhim të jashtëzakonshëm tu filluar prej institucioneve e deri te qytetarët që atakohen nga një situatë e jashtëzakonshme. Më bëri përshtypje fjala e z. Lutfi Rexhepit, e që është për tu përshëndetur iniciativa e tij për tu mbajtur një mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit, në atë kohë të vërshimeve, dhe i cili vuri në spikamë adresat në të cilat është thirrur gjegjësisht ka bërë një lloj lobimi për një mbledhje të jashtëzakonshme gjë e cila është për tu përshëndetur, mirëpo për një mbledhje të jashtëzakonshme janë disa procedura, e që zotëri Rexhepi, fillimisht e ka adresuar mirë atë çështje te Kryesuesi i Kuvendit, mirëpo nuk do të doja të del ashtu si e gjeneralizuar se të gjitha subjektet e kanë përgjegjësinë për mos thirrjen e një mbledhjeje të jashtëzakonshme, ne patëm rastin sot qysh në fillim të mbledhjes kur patëm para vetës diçka të jashtëzakonshme ku mund të kaloj me vota vetëm me shkelje të procedurës së vendimeve të Kuvendit, ashtu siç ishte rasti më hershëm, dhe ku votuan me procedurë të jashtëzakonshme pa e pasur materialin fare e futën në rend dite një propozim të drejtorit, e që sa unë jam në dijeni rendin e ditës mund të ndryshojnë Kryesuesi i Kuvendit dhe këshilltarët e Kuvendit e jo Ekzekutivi, por ne e patëm rastin të shohim që aj propozim vendim i drejtorit me 18 vota për, kaloj, andaj sa neve na bënë përshtypje përfillja e procedurave të Kuvendit u tregua në fillim të kësaj mbledhje. Pajtohem me z. Rexhepin se ka qenë dashur të ketë një mbledhje të jashtëzakonshme sepse Ekzekutivit të Komunës do t'i bashkëngjitej edhe një trupë vepruese prej 35 këshilltarëve të Kuvendit, e që do të ishte ndihmesë e madhe për Ekzekutivin.

Vërejtjet e mia konsistojnë me atë që, edhe kur kemi miratuar projektbuxhetin, po nga kjo foltore unë kamë kërkuar që Drejtorisë përkatëse t'i parashihet një fond për menaxhimin e situatave të jashtëzakonshme, po e them këtë ngase këtu u tha që ajo Drejtori nuk ka mjeti financiar të mjaftueshme për situata emergjente apo të jashtëzakonshme, tani ajo çka ka ndodh është e kaluar dhe me rëndësi është që nuk kemi dëme materiale në njerëz por ekzistojnë të gjitha mundësit që në të ardhmen të kemi një fatkeqësi tjetër elementare dhe nëse ne mbesim në këtë gjendje dhe mundohemi të hedhim fajin andej kënde, siç ishte rasti që për zyrtarët e agjencionit të menaxhimit që është bërë një vërejtje se nuk kanë qenë në nivel të detyrës e të cilët edhe në të ardhmen mund të mos jenë në nivel të detyrës por ne si Komunë jemi më afër atyre qytetarëve dhe jemi përfaqësues të atyre qytetarëve, mirëpo të tjerët mund të bëjnë çfarë të dëshirojnë por ne duhet të jemi pran qytetarëve dhe të jemi më afër atyre kur i'u paraqitet ndonjë vështirësi ashtu siç po dimë të jemi në fushata zgjedhore, sepse është përgjegjësi e jona.

Pra ishte edhe sugjerim nga Komiteti për Politikë dhe Financa që nuk ka vërejtje vetëm për një Drejtori të caktuar apo persona të caktuar por është vërejtje për komplet Ekzekutivin e Komunës por edhe e jona si Kuvend i Komunës, por unë them se tani patëm vërshime dhe kaluan ato por çfarë hapash ndërmorën ne pas atyre vërshimeve, është ngritur një komision për vlerësimin e dëmeve i cili në shumë vende nuk është parë, duke u nisur nga fshati në të cilin jetoj unë, fshati Llugë, e që është vendi i cili atakohet më së shumti nga vërshimet dhe mendoj që komisioni i ardhshëm, çoftë ai nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e që në mandatin e kaluar kemi pasur një miratim të Kuvendit që në një mbledhje të radhës kjo Drejtori të paraqes një raport rreth subvencioneve që ka ndarë dhe rreth gjendjes në Bujqësi dhe do të doja që nëse drejtori përkatës ka ndërmend të paraqes një raport të tillë t'i merr për bazë edhe dëmet e vlerësuara nga komisioni i cekur, se ku janë shkaktuar ato dëme, si janë shkaktuar, si i ka vlerësuar në mënyrë që të mos del se më shumë është e dëmtuar një kodër se sa në ndonjë vend të banuar buzë lumit, gjithashtu në Komitet për Politikë dhe Financa kemi propozuar që Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të bëjë dezinfektimin, dezinfektimin dhe derratizimin e vendeve ku kemi lumenj, dhe po ashtu kemi puse apo bunare të cilat nuk janë trajtuar me mjete kimike në mënyrë që të bëhet uji i pijshëm e që nuk janë gjëra të kushtueshme këto por vetëm mungon përkushtimi dhe angazhimi.

z. Flakron Gashi, theksoi, ne kemi pranuar nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit z. Faik Muçiqi, këtë raport për të cilin me plotë përgjegjësi e them se nuk është aspak profesional dhe mendoj se drejtori e din mirë se pse është kështu. Në pikën e parë të raportit përkatës ceken dëmet në infrastrukturë publike ku përfshihen disa rrugë nëpër disa fshatra, mirëpo nuk ceken se a janë apo nuk janë ato rrugë të asfaltuara, sa është gjatësia e rrugëve të dëmtuara, sa metra kub e kanë bllokuar rrugën, e të ngjashme, gjithashtu ceken edhe disa ura të dëmtuara ku ne të gjithë jemi në dijeni dhe është për marri që në disa fshatra kemi ura të drunjtë dhe është shumë turpëri për derisa kjo Komunë ka shfrytëzuar dhe ka keqpërdorur qindra mijëra euro shpenzime, si naftë për ngrohje, qymyr, derivate për automjete dhe dhjetëra mijë euro telefoni mobile dhe fikse, ndërsa sot ka ende ura të drunjtë. Çështja tjetër sa i përket sektorit të dëmeve në Bujqësi, është dashur të jetë një raport më specifik, thuhet se janë afër 70 ha tokë, e që afër mund të jenë edhe 65 edhe 69 edhe 68 ha, apo thuhet, të mbjellura kryesisht me patate, e që, me patate me kallamboq të tëra i keni përzier, por s'është problem, mirëpo në fund të këtij raporti thuhet që Kryetari i Komunës zotëri Veliu ka vendosur që drejtorët e tri Drejtorive të merren me gjendjen dhe vlerësimin dhe të vizitojnë fshatra për gjendjen e krijuar nga vërshimet, andaj unë kam dy pyetje për ju si drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe për kolegun (fjala është për Fidan Rekaliun) i cili thuri elozhe për Kryetarin e Komunës, dhe mos të harrojmë se këso vërshimesh kanë ndodhur edhe para disa viteve dhe ku janë masat preventive, dhe sot na është krijuar e njëjta gjendje, a thua a kanë funksionuar këto Drejtori të cilat përmenden këtu, pyetja tjetër është hedhja e mbeturinave në lumenj që u cek si shkaktar faktori njeri, unë pyes drejtorin se ku duhet t'i hedhin mbeturinat banorët e fshatrave.

z. Bahri Selimi, theksoi, mendoj se ndoshta është bërë pak e tepërt me këtë diskutim për këtë pikë dhe kamë fituar përshtypjen se diskutimet tona po mbeten vetëm diskutime dhe asgjë më shumë. Gjatë leximit të këtij raporti dhe gjatë dëgjimit të diskutimeve të parafolësve hasa në disa gjëra të cilat për mua janë shqetësuese dhe të cilat dua t'i ngriti

ndërsa për ju nuk jam në dijeni se a jeni apo nuk jeni të shqetësuar. Thuhet në raport se koordinimi në mes të institucioneve përkatëse ka qenë shumë në nivel dhe i kënaqshëm, ndërsa mandej thuhet se Kryetari i Komunës ka kontaktuar strukturat e FSK-së dhe ato nuk paskan dhënë përgjigje adekuate deri më sot, mandej thuhet, zyrtarët për menaxhimin e emergjencave nuk kanë qenë aktiv gjatë periudhës më të ndjeshme të vërshimeve në Komunën tonë, dhe tani këtu po krijohet një përshtypje se raportet e nivelit qendror dhe atij lokal a ekzistojnë apo nuk ekzistojnë fare dhe nganjëherë krijohet përshtypja se kemi inate në mes të nivelit qendror dhe nivelit lokal, mirëpo çka është më e keqja që krijon një përshtypje më negative se nganjëherë interesat partiake janë para interesave të qytetarëve, prandaj për këto gjëra do të kërkoja që të koordinohen punët sepse është shumë më e arsyeshme. Sa i përket dëmeve në sektorë të ndryshëm, në raport është thënë se vetëm janë bërë dëme në infrastrukturë, bujqësi dhe në ekonomi familjare, andaj mendoj se ky raport është vetëm sipërfaqësorë sepse është dashur të cekën dhe të specifikohen dëmet veç e veç si në infrastrukturë, në bujqësi ashtu edhe në ekonomi familjare. Çështja e fundit që dua të cekë dhe që kam pyetje për këtë, ka të bëjë me shkaktarët kryesorë të vërshimeve, reshjet e mëdha, ngushtimet e shtretërve të lumenjve, hedhja e mbeturinave dhe vendosja e ushqimeve të kafshëve u cekën shumë herë, për të cilat ka kohë që jemi në dijeni se janë shkaktarë të vërshimeve, prandaj pyetja konkrete e imja është, kur pritet të fillohet një renovim i këtyre mangësive, për këtë kërkoj përgjigje, dhe a është diskutuar ndonjëherë për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe për heqjen e mbeturinave apo punimin e një kanalizimi i cili është shumë i ndjeshëm në Komunën tonë.

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, sigurisht se për këshilltarët e Kuvendit është pak më lehtë të bëjnë pyetje sepse janë më shumë në numër, unë do të përpiqem t'ju jap shkurtimisht disa sqarime, ju falënderoj për disa pyetje dhe interesime nga ana juaj por për disa pyetje mendoj se kalojnë në nivelin e akuzave apo them më mirë e kalojnë instancën e pyetjes, interesimit apo vërejtjes, por meqë është debat i pranoj edhe ato.

Sa i përket raportit apo informatës së Drejtorisë të cilën e udhëheq unë, të cilin e keni para vetës, nuk ka të bëjë me raportin e komisionit për vlerësimin e dëmeve, sepse ky i fundit është shumë më i gjerë, ta marrim shembull, z. Flakron Gashi i përmendi urat, në raportin e komisionit për vlerësimin e dëmeve në pjesën e infrastrukturës precizohet gjendja e të gjitha urave, do të thotë unë nuk e kam rënduar raportin edhe me shënime tjera të veçanta, apo z. Haki Rudari e tha se nuk janë dhënë shuma të detajuara për dëmet në bujqësi, në fakt është dhënë 70 ha mirëpo nuk jam lëshuar në detaje të raportit të komisionit, andaj nëse ndokush nga ju është shumë i interesuar mund të merrni individualisht raportin e komisionit për vlerësimin e dëmeve, sepse nuk kemi asgjë të fshehtë ne dhe se aty ku janë bërë dëme ne i kemi, pra dëmet në infrastrukturë janë bërë kryesisht në ura të ekonomive familjare dhe lagjeve apo ura të drunjta me konstruksioni të dobët, dhe për të gjitha dëmet ka qenë një komision i posaçëm i verifikimit të urave në Komunën tonë cili ka punuar shumë dhe të gjitha ato dëme që i kanë hasur i kanë evidentuar dhe i ka vlerësuar, vlen të theksohet se të gjitha urat që janë ndërtuar kanë qenë stabile dhe nuk është dëmtuar asnjë prej tyre por kanë pësuar urat e konstruksionit të dobët e të cilat ne menjëherë nuk mund t'i ndërtojmë gjë të cilën j'u ka kemi thënë edhe banorëve të atyre lokaliteteve si në fshatin Repë, Murgull etj, pavarësisht presioneve dhe dezinformatave që janë bërë edhe gjatë kësaj fushate ku një televizion ka bërë informatë

se nuk ka dalë në terren pushteti lokal, ndërsa pikërisht në ato lokalitete kanë qëndruar rregullisht tërë ditën, dua të them se nuk qëndron ajo që duhet të merremi me bindje individuale të qytetarëve qofshin ato bindje pozitive apo negative sepse ndokush mund të lëvdojë e ndokush të kritikoj por nuk është esenca aty, mirëpo për secilën urë, rrugë e të tjera, aty ku është punuar janë shënimet do të thotë është komponentë e infrastrukturës publike. Sa i përket fondeve, është e lehtë që të thuhet tani se Ekzekutivi i Komunës është fajtorë, ne absolut nuk mund dhe nuk dëshirojmë t'i ikim përgjegjësisë mirëpo të trajtohen gjërat pak më gjerë sepse ku qëndron problemi të lumenjtë apo gjerësia tyre apo ndonjë gjë tjetër, fatmirësisht në Komunën tonë kemi shumë lumenj, por a mund të trajtohen të gjithë përnjëherë apo për dy tri vite në mënyrën se si duhet të trajtohen, shembull siç është pjesa e lumit Llap në qytet ku të gjithë ne e kemi parë se niveli i ujit ka qenë përafërsisht pran maksimumit e që mendoj që ky investim i madh që është bërë e ka shpëtuar qytetin nga vërshimet. Ne tani mund të themi pse nuk është investuar më shumë në bujqësi apo ndonjë sektor tjetër, mirëpo ndërrimi i strukturës së buxheteve dhe investimeve buxhetore mund të bëhet, pra nga ato investime që janë bërë në rregullimin e rrugëve me asfalt apo në kanalizim mund të kalojnë në rregullimin e lumenjve apo rregullimin e ambientit gjë të cilën edhe unë e mbështes, mirëpo unë prapë i konsideroj këto sugjerime, vërejtje apo pyetje si të dobishme.

U përmend Plani i vlerësimit të rrezikshmërisë në Komunë, ky plan ekziston, nuk do të thotë se është i përkryer por është në nivelin e disa Komunave, në këtë Plan kam marrë pjesë edhe unë dhe i kam shoqëruar disa sektorë, me siguri se do të keni atë plan sepse çdo pesë vite revidohet dhe do të keni mundësi të na ndihmoni se ku mungon ndonjë pikë e ndjeshme dhe të plotësohet ai plan, ndërsa sa i përket asaj se nuk është thirrur një mbledhje e jashtëzakonshme unë nuk mund të flas sepse nuk është kompetencë e imja. Mund t'ju them se kemi një përvojë jo të mirë të gjendjeve të jashtëzakonshme këtë e ndërlidhi me borën e madhe që ka qenë para dy tri viteve.

Pajtohem që në raste të tilla të fokusohemi më shumë, dhe jam për atë që ndoshta në një të ardhme të ulemi dhe të bëjmë ristrukturimin e Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim me qëllim të pasurimit të këtij Komiteti edhe me anëtarë të rinj, apo edhe të Kuvendit, pse jo, në mënyrë që të ngritet gjendja e gatishmërisë, por nuk pajtohem që Kryetari i Komunës të shpall gjendje të jashtëzakonshme ngase këtë mund ta bënte vetëm Presidenti/ja e shtetit, pra të shpall gjendje të jashtëzakonshme në vend, ndërsa Kryetari i Komunës mund të thirr Komitetin e cekur. z. Bahri Selimi e cekur se ka pasur mos profesionalizëm, unë nuk dua të merrem me këtë çështje se a ka apo jo profesionalizëm, por dëshiroj të theksoj se sa i përket nivelit komunal ka qenë shumë koordinim i mirë, gjithashtu me nivelin qendror përkatësisht me qendrën operative kemi pasur në vazhdimësi kontakte dhe me Agjencionin për menaxhimin e emergjencave për të cilin them se nuk është në nivel të detyrave në raport me Komunitat jo vetëm me Komunën tonë por me komunitat në përgjithësi, këto gjëra i kemi diskutuar në takime me Ministrin e Punëve të Brendshme por janë disa probleme edhe me Zjarrfikësit, i përmenda këto me qëllim që në të ardhmen t'i kemi si tema për të cilat mund ti diskutojmë haptas dhe më hollësisht se ku është niveli i shërbimit të Zjarrfikjes në Kosovë, niveli i koordinimit mes Agjencionit për Menaxhimin e Emergjencave dhe Komunave dhe niveli i organizimit të vetë sektorëve të Komunave. Patëm edhe pyetje se ku mund të hedhen mbeturinat, unë them që qytetarët duhet të përfshihen në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, qoftë në fshatin Repë, qoftë në Llapashticë, qoftë në qytet, për fatkeq në pjesën më të madhe të fshatrave nuk është i

shtritur ky rrjet i menaxhimit të mbeturinave por shpresoj se shumë shpejt do të zgjerohet ky rrjet, ne edhe në pjesët periferike të qytetit kemi probleme sepse nuk po mundemi t'i bindim qytetarët të përfshihen në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, pra nuk dëshirojnë t'i japin pesë euro në muaj për të mos pasur problemin e hedhjes së mbeturinave dhe përderisa nuk janë të përfshirë në atë sistem, ato mbeturina me siguri se do t'i hedhin në lumenj, gjë e cila nuk është në rregull aspak, mirëpo kjo është gjendja e cila po na ndodh, ne kemi kërkuar nga kompania Pastrimi që ta zgjeroj kapacitetin, ndërsa për ato vende që nënshkruhet kontrata kompania është e obliguar të shkoj dhe të marr mbeturinat.

Kërkoj falje nëse e zgjata, konsideroj se pat edhe më shumë pyetje dhe interesime tjera për të cilat jam i hapur kurdo që të doni t'ju jap sqarime dhe përgjigje jo vetëm në Kuvend por edhe në zyre.

z. Flakron Gashi, theksoi, (i përgjigjet parafolësit) meqë me profesion jam jurist e kam për obligim të të sqaroj një gjë, nuk u ngritën akuza këtu dhe i nderuar drejtor duhet ta dallos akuzën, nga thirrja në përgjegjësi për pozitën të cilën e ushtron e që është pozitë zyrtare. Akuzat ka për disa ish drejtor të juaj për të cilët ju jeni në dijeni shumë mirë. Unë të kërkoj ndjesë nëse ti u ndjeve i akuzuar mirëpo shfrytëzoj dhe kryej detyrat të cilat të përcaktohen me ligj që ti në të ardhmen të mos jesh në mesin e të akuzuarve.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, është e vërtetë që ka qenë kërkesë e AAK-së gjegjësisht e z. Lutfi Rexhepit që të mbahet një mbledhje e jashtëzakonshme gjatë atyre ditëve që kanë ndodhur vërshimet, ju njoftoj se kemi qenë në kontakt permanent me Ekzekutivin e Komunës dhe me Nivelin Qendrorë dhe sa jam në dijeni asnjë komunë nuk ka mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme, gjithashtu më duhet të potencoj se Ekzekutivi i Komunës ka qenë i mobilizuar gjë për të cilën e përgëzoj për punën e tyre, por natyrisht se për një situatë të tillë të krijuar ka vend edhe shqetësime. Në Komitetin për Politikë dhe Financa kemi nxjerr disa rekomandime të cilat besoj se do të jenë edhe rekomandime të Kuvendit, në vijim do t'i lexojë rekomandimet:

- 1- i rekomandohet Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të merr parasysh gjendjen e familjes Kuleta nga fshati Tërnavë të cilës nga vërshimet i'u është dëmtuar shtëpia
- 2 - në prioritet për periudhën e ardhshme të përfshihet zgjerimi dhe rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe prockave
- 3 - të ndërmerren masa ndaj të gjithë atyre të cilët kanë uzurpuar paluajtshmërinë e shtretërve të lumenjve dhe prockave dhe të gjithë atyre të cilët hedhin mbeturina në lumenj, dhe
- 4 – të bëhet derratizimi, dezinfektimi dhe dezinfektimi afër shtretërve të lumenjve dhe në pjesë tjera varësisht nga paraqitja e nevojës

Pra këto ishin disa nga rekomandimet e Kuvendit të cilat duhet t'i ketë parasysh Ekzekutivi i Komunës, me qenë se kjo është vetëm një informatë dhe nuk ka nevojë për hedhje në votim, këtu do të mbylлим debatin për këtë pikë të rendit të ditës, dhe kalojmë në pikën vijuese.

3. Propozimi i Rregullores për caktimin e kriterëve për dhënien e shtëpive në pronësi të Komunës në shfrytëzim në lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa për informim në një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi debatuar mjaft gjerë për këtë pikë të rendit të ditës, dhe pastaj kemi vendosur që të shqyrtojmë nën për nën, dhe aty ku kemi pasur ndonjë gjë për të ndryshuar apo plotësuar e kemi bërë atë, ne si Komitet e kemi votuar dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për miratim.

z. Bahri Selimi, theksoi, në këtë propozim rregullorë është paraparë të trajtohen pothuajse njësoj, si familjet në gjendje të rëndë sociale-ekonomike, familjet e Dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranët e luftës, jam në dijeni se në KPF këtë propozim e keni diskutuar bukur gjatë por unë kam një propozim konkret nëse pajtoheni të gjithë që, familjeve të Dëshmorëve të cilët jetojnë në Lagjen e Dëshmorëve t'ju hiqen të gjitha kriteret, pra të mos përfshihen në kriterë por t'ju jepet prioritet dhe të jenë përfitues të parë, ndërsa për familjet e kategorive tjera të cilat janë të cekura në këtë propozim të përfillen të gjitha kriteret

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, propozim rregullorja është i bazuar në Ligjin për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe në Memorandumin e nënshkruar mes Komunës së Podujevës dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, gjithashtu është i ngritur nga Kuvendi i Komunës edhe komisioni për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, komisioni i cili në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe me Zyrën Ligjore kanë punuar shumë në përgatitjen e këtij dokumenti të cilët i falënderoj shumë për punën e tyre, andaj Komiteti për Politikë dhe Financa e ka shqyrtuar çdo pikë dhe nuk e ka parë të arsyeshme që të futet apo hiqet ndonjë nën nga ky propozim, mirëpo nëse konkretisht keni ndonjë propozim ndokush nga ju mund të paraqitni.

z. Kadri Avdiu, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës ne kemi diskutuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe është kërkuar që të kemi në dispozicion për këtë mbledhje Memorandumin e nënshkruar nga Komuna e Podujevës dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale gjë për të cilën jemi pajtuar të gjithë por që nuk është përfillur dhe nuk e di arsyen. Ne jemi në dijeni se një fazë e ndërtimit të shtëpive është përfunduar dhe janë ndërtuar 30 shtëpi nga Ministria përkatëse por obligimet të cilat i ka Komuna nuk janë përfunduar, e them këtë ngase ato shtëpi kanë mundur veç të ndahen mirëpo tani komisioni nuk mund të merr vendim për ndarje sepse nuk është e kryer infrastruktura e cila ka qenë në përgjegjësi e Komunës, unë prapë po e përsëris se po të kishim në dispozicion Memorandumin e cekur do të kishim shumë më të lehtë të marrim sot vendim. Lidhur me propozimin që e bëri z. Bahri Selimi, pajtohem plotësisht sepse për këta është edhe iniciativa e Ministrisë, por duke mos i përjashtuar tjerat kategori sepse nuk kemi të drejtë të përjashtojmë askënd, por prioritet, si me kriterë si pa kriterë, duhet të jenë familjet e Dëshmorëve, unë jam pjesë e komisionit për ndarjen e këtyre shtëpive dhe mendoj se nuk duhet të merren parasysh kriteret për familjet e Dëshmorëve dhe kjo të jetë një prioritet dhe është qëndrim nga ana ime.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, ne Lëvizja për Bashkim mendojmë se prioritet në përfitimin e shtëpive duhet të kenë familjet e Dëshmorëve dhe se për këto familje nuk duhet të vlejnë kriteret të cilat parashihen në këtë propozim rregullore. Ne të gjithë jemi në dijeni se çfarë kanë bërë Dëshmorët e Kombit dhe familjet e tyre për këtë vend, andaj duhet të kenë përparësi në këtë çështje.

z. Haki Rudari, theksoi, unë jam anëtar i komisionit për ndarjen e shtëpive në atë lagje dhe kam marr pjesë në takimin e mbajtur nga ky komision, këtu prezent është edhe kryesuesi i komisionit z. Avni Ajeti, së pari në atë takim na është thënë se do t'na e sjellin komplet listën e të gjitha familjeve që jetojnë në Lagjen e Dëshmorëve, së dyti na është thënë se do t'na e sjellin edhe Memorandumin e nënshkruar nga Komuna e Podujevës dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale gjë që nuk është bërë dhe së treti, qysh në takimin e parë unë kam bërë pyetje se sa është numri i familjeve që jetojnë në atë lagje, më është thënë se numri i atyre familjeve është 120, ndërsa në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa nga ana e drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale na është thënë se numri i familjeve që jetojnë në atë lagje është 131, do të thotë brenda një jave ndryshon ky numër dhe na dalin 11 familje më shumë.

Sa i përket propozimit të z. Bahri Selimit, e përkrahi plotësisht dhe mendoj se është shumë e arsyeshme që të gjithë këshilltarët e Kuvendit ta përkrahin këtë, mirëpo kjo çështje duhet të futet në rregullore sepse ne si komision nuk mund të marrim kurrfarë veprimesh të cilat nuk janë të përfshira në Rregullore.

Prandaj kërkoj që propozimi i zotëri Selimit të futet në rregullore, sepse për ne si komision që jemi do të kemi më të lehtë punën tonë, përndryshe ne do të jemi të obliguar të zbatojmë vetëm rregulloren andaj edhe konsideroj se duhet pasur kujdes që të përfshihen të gjitha në të.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, për të gjitha këto që u thanë deri më tani në këtë mbledhje ne jemi pajtuar edhe një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa që të gjendet mënyra më e mirë e mundshme për ndarjen e këtyre shtëpive, andaj nuk e shohë të arsyeshme që kjo çështje të diskutohet edhe më gjatë ngase të gjithë i kemi dhënë dhe jemi pajtuar me disa vërejtje të cilat ishin vërejtje me vend, pra të gjithë jemi pajtuar dhe nuk kemi pasur kurrfarë dallimesh, qoftë partiake apo të tjera.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket propozimit të z. Bahri Selimit, unë sapo u konsultova me Zyrtarin ligjor, këto çështje rregullohen me Ligjin për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, ku ndër të tjera ky ligj parasheh edhe të gjitha ato kritere të cilat janë paraparë në propozim të kësaj rregulloreje, kështu që për propozim rregulloren përkatëse ne jemi bazuar në këtë ligj dhe në Memorandumin e nënshkruar nga Komuna e Podujevës dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Memorandum ku secili nga ju mund ta keni në disponim pasi të kalon kjo mbledhje, dhe mendoj se ky propozim është në harmoni të plotë me këto akte.

z. Bahri Selimi, theksoi, Kryesuesi e potencoi se kjo propozim rregullore është në harmoni me Ligjin përkatës, unë këtë e kam parasysh mirëpo ne si Kuvend po miratojmë një rregullore dhe në një far forme ne jemi ligji këtu dhe ne jemi ata të cilët e miratojmë këtë. Pra unë pa dashur t'i anashkaloj familjet e kategorive tjera, sepse të gjitha ato meritojnë të trajtohen, andaj propozimi që unë kërkoja për familjet e Dëshmorëve mendoj që është i arsyeshëm që të paktën këto familje ta gëzojnë një privilegj më shumë se kategoritë tjera, sepse janë familjet më të dëshmuara në vend për këtë që ne e gëzojmë sot.

Pra unë kërkoj që në këtë rregullore të futet një nen i veçantë, dhe në atë nen të ceket se Familjet e Dëshmorëve janë të përjashtuara nga kriteret dhe janë përfituese të para.

z. Avni Ajeti, theksoi, në cilësinë e kryesuesit të komisionit dëshiroj të informohem rreth infrastrukturës se a kemi ndonjë plan apo ndonjë kohë të caktuar për përfundimin e atyre punimeve, ose çka më tutje, sepse ne jemi duke biseduar këtu për familje të Dëshmorëve dhe për kriteret të ndryshme, ndërsa ne si komision nuk jemi në dijeni dhe nuk mund t'ju japim kurrfarë përgjigje atyre familjeve sepse nga ana e tyre ka të interesuar dhe pyesin.

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, parafolësi bëri pyetje rreth infrastrukturës dhe për këtë mora fjalën, në Memorandumin e nënshkruar nga Komuna e Podujevës dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale thuhet në një pikë që Komuna obligohet të kryej infrastrukturën përcjellëse, ndërsa punët tjera i përkasin Ministrisë. Drejtoria të cilën e udhëheqë unë i ka iniciuar procedurat e prokurimit për infrastrukturën e ujit, kanalizimit dhe energjisë, dhe besoj se me procedurë të përshpejtuar sipas projektit që i'u është bërë dhe shpresojmë që në një periudhë të shpejt t'i kryejmë ato punë, ndërsa komisioni tani ka edhe rregulloren dhe mund të filloj me sistematizimin e përzgjedhjes për ato shtëpi të cilat janë kryer, kështu që kjo çështje të mos ju mundon juve si komision, sepse ajo infrastrukturë për 30 shtëpitë e para do të kryhet shumë shpejtë, meqenëse tash është faza e dytë, sepse kemi dy faza, në atë hapësirë kemi edhe probleme hapësinore për të cilat tani nuk dëshiroj të flasim, por kemi kërkuar pëlqim edhe nga ujësjellësi për ujin, kemi kërkuar pëlqim edhe për kanalizim edhe për rrjet energjetik, gjë që shpresoj se shumë shpejt do të marrim përgjigje pozitive nga kompanitë përkatëse, por pavarësisht kësaj ne kemi hyrë në procedura dhe do t'i kryejmë këto detyra sipas Memorandumit të cekur, pra është mirë që komisioni të jetë në kontakt edhe me neve si Drejtori në mënyrë që puna të kryhet sa më shpejt.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, i kam parasysh vërejtjet dhe propozimin që bëri z. Bahri Selimi e që mendoj se është shumë e drejtë, por konsideroj se të gjitha ato janë të përcaktuara në propozim rregullore ku përkatësisht familjet e Dëshmorëve poentohen dhe i kanë përparësitë e tyre, dhe nuk mendoj se do të ishte e nevojshme të ndryshohet apo plotësohet propozimi i rregullores, pra për mua nuk paraqet kurrfar problemi ky ndryshim por e përsërisë se të gjitha ato vërejtje që u dhanë dhe propozimi i bërë janë të rregulluara konform ligjit përkatës, dhe ne jemi në dijeni se ligji ka fuqinë juridike më të madhe se një akt i Kuvendit të Komunës.

z. Kadri Avdiu, theksoi, zotëri Kryesues i Kuvendit të mos ngatërrohen gjërat duke thënë se ligj e thotë kështu, rregullorja kështu. E them këtë ngase që 14 vite me radhë shkelet ligji në 90% të rasteve nga ana juaj, siç e patëm rastin në këtë mbledhje ku u fut në rend dite një pikë shtesë pa i kaluar procedurat por vetëm duke u thirr në numra, sido që të jetë me këto punë ka kush merret por unë e kam për obligim t'ju jap vërejtje. Po e përsërisë dhe një herë, çka ka të keqe ajo që e propozoi z. Bahri Selimi, ngase ky Kuvend e ka ndërruar edhe emrin e asaj lagjeje nga Lagja e Kuvajtit në Lagje të Dëshmorëve dhe ajo lagje në fillim është ndërtuar për familje të Dëshmorëve ndërsa pastaj janë tjetërsuar dhe janë përfshirë edhe familje të tjera, ngase jeta pas luftës ka qenë e ngulfatur gjë që është munduar të gjenden zgjidhje dhe është pushtuar ajo lagje me raste të sociale, ndërsa në atë Lagje jetojnë rreth 15 – 16 familje të Dëshmorëve, gjithashtu në Memorandumin e nënshkruar nga Komuna e Podujevës dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është e potencuar si Lagje e Familjeve të Dëshmorëve

andaj përparësia duhet të jetë për familjet e Dëshmorëve, këtë nuk kemi çka e diskutojmë. Pra çka ka të keqe që ky Kuvend të mbështet propozimin e zotëri Bahriut.

Ne mbështesim dhe konsiderojmë se duhet të mbështetet propozimi që të futet edhe një nen në këtë rregullore ku për familjet e Dëshmorëve në rastin e ndarjes së shtëpive të mos vlejn kriteret, apo thënë ndryshe ato familje të përjashtohen nga të gjitha kriteret.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se të gjitha diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës u shterën, andaj e hedh në votim këtë propozim rregullorë, me plotësimin e propozuar nga z. Bahri Selimi që në rregullore të futet një nen i veçantë me të cilin, në rastin e ndarjes së shtëpive në fshatin Balloc, të përjashtohen të gjitha kriteret për familjet e Dëshmorëve.

Pas votimit u konstatua se njëzëri miratohet propozim rregullorja, me plotësim duke u përfshirë edhe neni i propozuar me të cilin, në rastet e ndarjes së shtëpive të ndërtuara në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, familjet e Dëshmorëve të jenë të përjashtuara nga të gjitha kriteret e parapara.

Pas disa kërkesave të disa këshilltarëve të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit vendosi që nga ora 11: 55 deri në ora 13:00, të ketë pauzë.

Pauza.

Fillimisht, u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

4. Propozimi i Planit vjetor të punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2014

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, jeni në dijeni se ky Këshill është themeluar nga Kuvendi i Komunës më 13 mars 2014, kështu që ky Plan nuk ka mundur që të vihet më herët për miratim në Kuvend, andaj pasi ky Plan është miratuar në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi është proceduar në Kuvend. Gjithashtu ju njoftojë se këtë Pikë të rendit të ditës e kemi diskutuar edhe në Komitet për Politikë dhe Financa, kështu që nëse ndokush dëshiron të merr fjalën, unë e hapi debatin.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, është mirë që kemi një Plan të punës nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, për shqyrtim në Kuvend. Unë mendoj se pika 26 e këtij Plani është dashur të jetë në pikën 1 të këtij Plani, pra është dashur që ky Plan të miratohet në mbledhjen e parë të Kuvendit, tani në prag të gjashtëmujorit të vitit ne duhet të merremi me shqyrtim të këtij Plani, kurse tani jemi në fazën kur Kryetari i këtij këshilli, i cili vetë e ka cekë në pikën 25 të këtij Plani që të raportohet në Kuvend dy herë brenda vitit për aktivitetet e Këshillit, dhe sigurisht se ky raport, moralisht është dashur të bëhet çdo gjashtëmujor e që i bie në muajin qershor dhe në atë dhjetorë, do të thotë, ne tani e kemi Planin e cekur për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, kur jemi në fund të muajit maj ndërsa në muajin e ardhshëm është paraparë të raportohet para Kuvendit, çka do të thotë se raporti bëhet pas një muaji ndërsa pesë muaj të tjerë kanë shkuar.

Çështje tjetër të cilën e vërejtja, është pika 10 e këtij Plani e cila ka të bëjë me trajtimin e qenve endacak, Policia e Kosovës, kur dihet se Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë është në përbërjen e këtij Këshilli, Shoqatat e gjuetarëve gjë për të cilën besoj

se ne të gjithë jemi në dijeni se vrasja e qenve endacak është e ndaluar me ligj, por duhet të bëhet një trajtim tjetër e që është injektimi ose kastrimi i qenve endacak apo izolimi i tyre në qendra të caktuara, kështu që kjo është në kundërshtim me ligjin sepse kemi të bëjmë me zhurmë dhe shkrepte me armë zjarri në vende publike, pra kjo ishte një ndër vërejtjet për këtë Plan, tjetër çështje kemi edhe, inicimi i aktiviteteve për parandalimin e vërshimeve, në pastrimin e lumenjve do të thotë se ka ndërlikime me defektin e drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit në rastin e vërshimeve e që ka ardhur deri te ajo për të cilën jemi në dijeni të gjithë, shkaku që se kemi pasur Planin e miratuar, me q'rast do të përmendi një prej punëve ku gjatë fazës së zhvillimit të kanalizimeve në fshati Sfeqël gjatë kohës së vërshimeve uji i ka hequr nga vendi i tyre të gjithë gypat, ne jemi në dijeni se sa duhet të jenë me parametra minimum me standard të infrastrukturës ku më pak se 70 cm nuk guxojnë të jenë ndërsa në atë fshat kanë qenë shumë cektë ku tre prej tyre i ka hequr krejt nga vendi tyre gjë të cilën më ka ardhur rasti ta shoh.

Meqë drejtori i Drejtorisë përkatës nuk është prezent këtu po të drejtohem ty zotëri Kryesues (tregon me foto), në projektin e fundit është zhvilluar kjo punë në infrastrukturë të një kanalizimi në fshati Llapashticë të Epërme ku janë shpenzuar 270,000.00 €, ku gjatë fazës së punimeve nuk ka zhavorr dhe shihet personi duke shkelur mbi gypa gjë për të cilën mendoj se do të ketë defekte. E përmenda këtë ngase kemi të bëjmë me pikën e Planit të cekur për sigurimin ndaj vërshimeve. Kështu që në këtë mbledhje do të dëshiroja të jenë prezent Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi dhe të kemi një raport të punës që është bërë nga ai Këshill.

Pra sigurisht se duhet të ketë një Plan të punës Këshilli përkatës por konsideroj se tani është vonë sepse jemi pran gjashtëmujorit të vitit dhe tani do të duhej të bëhej raport në Kuvendin e Komunës nga ai Këshill.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ne këtë Plan e kemi diskutuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, i kemi parasysh vërejtjet që i bëri parafolësi por nuk mendoj se duhet të ndërhyjmë në punën e këtij Këshilli për mënyrën e zbatimit dhe raportimit para Kuvendit apo ndonjë ndryshim të Planit sepse funksionimi, raportet dhe planet e këtij Këshilli janë të rregulluara dhe zbatohen konform legjislacionit në fuqi.

z. Naim Çunaku, theksoi, është mirë që është bërë një Plan i veprimt nga ky Këshill dhe që për herë të parë ka filluar të punohet ashtu siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi, mirëpo më bëri përshtypje ku hartuesi në një formë e specifikon se si do të menaxhon gjegjësisht si do të drejton këtë këshill por për habi nuk ka asnjë afat kohorë. Më bëri të marrë fjalën një çështje që Kryesuesi e ceku, "ashtu siç Këshilli e ka paraparë ashtu të na raportoj ai Këshill". Asnjë afat kohorë, asnjë datë dhe asnjë parametër kohorë nuk është i përcaktuar në këtë Plan, do të thotë se është një Plan për më tepër një përmbushje formale, por sido që të jetë më mirë pak se hiq dhe ne deshëm apo nuk deshëm do ta mbështetim këtë Plan jo që është Plan i mirë por për arsye se ka filluar të aplikohet ashtu siç e kërkojnë rregullat, por dhe që të ketë Plan Pune të KKSB-së, në mënyrë që mos të na ndodh sikurse Drejtoritë e Ekzekutivit të cilat nuk kanë Plan Pune, të paktën ky Këshill ka provuar të bëjë diçka.

z. Haki Rudari, theksoi, pajtohem me kolegët parafolës, unë dua të ngriti një çështje te pika 5 e Planit ku thuhet, raporte periodike nga Drejtoria e Arsimit për siguri në shkolla dhe afër shkollave. Konsideroj se ne këshilltarët e Kuvendit paraprakisht është dashur t'i kemi raportet e mbledhjeve që ka mbajtur ky Këshill, dhe çështja tjetër që dua të ngriti ka

të bëjë me sigurinë nëpër shkolla, dhe kam pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe për Këshillin e cekur se pse është hedh sprej në shkollën ekonomike kur nxënësit e kanë pasur mbrëmjen e maturës, është lista e qytetarëve tanë, gra, fëmijë dhe të tjerë që kanë kërkuar ndihmë në emergjencë si pasojë e dhunës nga ana e Policisë, dhe ne si këshilltarë të Kuvendit, mendoj se është dashur të jemi në dijeni se pse ka ndodhur kjo. Kur jemi të siguria në shkolla, vazhdimisht ka rrahje të nxënësve dhe lëvizje të personave të cilët nuk janë personel i mësimi gjë për të cilën është dashur të punohet më shumë. Një çështje tjetër të cilën po ashtu dua të ngriti ka të bëjë me pikën 15 të Planit, ku thuhet, masat parandaluese në Liqenin e Batllavës, e për këtë unë ju pyes të gjithë juve këtu, se me çfarë të drejte i ndalin në hyrje të Liqenit qytetarët të cilët udhetojnë me vetura disa njerëz afër policisë, mendoj se këtë të drejtë e kanë vetëm policia, qytetarët kanë të drejtë të shkojnë në varrime, dreka, dasma, ahengje dhe të shëtisin andej e kënde, por ata njerëz të cilët janë civilë nuk kanë të drejtë t'i ndalin qytetarët, këtë problem e ka pasur shkolla ku unë punoj ku me rastin e shkuarjes në ekskursion është ndalur autobusi gjë e cila ka mundur shumë lehtë të vie deri te ndonjë mosmarrëveshje. Pra edhe një herë po e përsëriti se është mirë të jemi në dijeni se këshilltarët e Kuvendit se me leje të kujt dalin ata njerëz në hyrje të Liqenit të Batllavës dhe i legjitimojnë qytetarët.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, propozoj gjegjësisht insistoj që në këtë Plan pune të futet edhe një analizë apo diskutimi disa praktikave të Policisë së Kosovës gjegjësisht Stacionit të Policisë në Podujevë, ku ekipet shoqëruese të ndërmarrjeve publike, të KEDS-it, Ujësjiellësit etj, për shkak të borxhit të pa inkasuar nga konsumatorët ata punëtorë i shoqëron Policia gjatë shkyçjes së energjisë elektrike ose ujësjiellësit, konsideroj se Policia bënë shkelje ligjore në këtë rast dhe nuk as një bazë ligjore për këto veprime, prona private është e shenjtë, andaj Policia t'i hynë në oborr dikujt pa vendim të gjykatës apo pa urdhëresë të shkruar të eprorit të vetë është drejtpërdrejt shkelje edhe e privatësisë edhe e lirisë qytetare. Këta zotërinj për një grusht lekë i mbështesin këto ndërmarrje publike të cilat janë profitabile. Inkasimi i borxheve duhet të bëhet në mënyrë tjetër, janë rrugët ligjore dhe është gjyqësia. Prandaj kjo çështje duhet të diskutohet në atë Këshill dhe duhet të raportohet para këtij Kuvendi se cila është baza ligjore e këtyre veprimeve.

z. Kadri Avdiu, theksoi, në mandatin e kaluar kemi kërkuar disa herë që ky Këshill të harton Planin e punës por asnjëherë nuk ka ardhur në Kuvend, është e mirë që tani ka filluar të aplikohet kjo rregull, ndërsa a është apo nuk është gjithëpërfshirës dhe i shkruar mirë ky Plan i'a lëmë kohës dhe vlerësimin e bëjmë pas andej, mirëpo problemi qëndron se sa do të zbatohet ky Plan në praktikë dhe në ndër kohë ne do t'i bëjmë vërejtjet tona se ku janë bërë lëshimet.

Sa i përket asaj që e potencoi z. Lutfi Rexhepi se policia është për të ruajtur sigurinë, është e vërtetë që me ligj ashtu është rregulluar, mirëpo shpesh herë ndodh që në vend që të mbrohet siguria e qytetarëve nga ana e policisë në shumë raste me disa veprime ata vetë e shkelin sigurinë e qytetarëve, e them këtë duke pasur parasysh edhe atë që e potencoi z. Haki Rudari që përdoret sprej në shkolla. Ne disa jemi dëshmitarë të helmimeve të nxënësve në shkolla që ka ndodhur para luftës, ndërsa tani nga Policia e Kosovës përdoret gati e njëjta gjë para fëmijëve tanë, gjithashtu kemi raste kur Policia përdorë dhunë fizike ndaj të miturve, ndërsa sa i përket shoqërimit të Policisë së Kosovës me ato Ndërmarrje publike unë jam në dijeni se ka një memorandum mes tyre, mirëpo

kemi edhe raste kur kemi të bëjmë edhe me kompani private ku në momentin që paguhet policia është në gjendje të shkel komplet procedurën ligjore.

Ky Këshill është i përbërë nga Kryetari i Komunës, Komandanti i Stacionit të Policisë dhe i gjithë stafi tjetër, dhe unë mendoj se ne si këshilltarë të Kuvendit duhet t'jua tërheqim vërejtjen, sepse Policia është për të mbrojtur ligjin, ndërsa për tjera çështje janë Gjykatat dhe Prokurorit, e mos të kemi raste që polici të bëhet edhe gjykatës edhe prokurorë vetë. Pra nuk kam dëshirë të kthehet gjendja e jashtëzakonshme e viteve të 90-ta kur Kosova pushtohet nga MUP-i i Serbisë, dhe këtë gjë ja kam thënë edhe Komandantit të Stacionit të Policisë. Pra rreth Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, punës dhe raportimeve të tij, si dhe për gjendjen e përgjithshme në territorin e Komunës tonë, do t'i japim vërejtjet tona në të ardhmen.

z. Avni Ajeti, theksoi, u fol rreth përdorimit të sprejit nga ana e Policisë, dhe pati akuza nga z. Haki Rudari dhe nga z. Kadri Avdiu, mirëpo ne nuk jemi në dijeni dhe nuk kemi kurrfarë informatash pse ka ndodhur ajo, dhe mendoj se Policia në një far forme kanë të drejtë të përdorin sprej kur ka të bëjë si masë parandaluese, shembull, nëse Policia kërkon lirin e rrugës, jap urdhër apo gjëra të ngjashme, dhe nëse qytetarët kushdo qofshin ata nuk ju binden, atëherë kanë të drejtë t'i marrin disa veprime sepse për ata edhe janë Policët.

Pas votimit u konstatua se me 30 vota për, 3 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua Plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2014

5. Propozimi i Vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës – lokal afarist

z. Abaz Lugaliu, në fjalën hyrëse për këtë pikë të rendit të ditës ndër të tjera shtoi, këtu bëhet fjalë për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim gjegjësisht lokalit afarist në pronësi të Komunës e që deri më tani ka qenë duke e shfrytëzuar Banka Private e Biznesit por që nga 1 maji 2014, me njoftim paraprak një muaj përpara ka bërë të ditur se heqë dorë nga shfrytëzimi i mëtutjeshëm i atij lokali me arsyetim se ka gjetur lokal më të përshtatshëm për kryerjen e veprimtarisë së tyre.

Andaj kërkoj nga Kuvendi që të miratohet ky propozim vendim, e më pastaj të veprohet sipas procedurave ligjore ku së pari del njoftimi për aplikim, shpallet në ueb faqe të Komunës e pastaj komisioni i themeluar nga ky Kuvend do të bëjë vlerësimin dhe shpalljen e ofertuesit më të mirë.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, edhe pse ne si këshilltarë të Kuvendit nuk e kemi një regjistër të pronave publike, gjë për të cilën kërkoj që në seancën e ardhshme së paku unë të kem një regjistër të pronave publike. E përkrahi dhe jam për të dhënë pronat publike në shfrytëzim me qëllim që të krijojmë të hyra për Komunën, gjithashtu mendoj se është ofruar koha të përfundimit të atyre pronave të cilat janë dhënë në shfrytëzim për 15 vite dhe është mirë të diskutohet në Kuvend se a duhet t'ju vazhdohet mandati edhe për 15 vite. Çështje tjetër për diskutim kam edhe tendat, karriget dhe tavolinat për të cilat kam kontaktuar me shumë qytetarë të cilët më kanë thënë se kemi leje prej Komunës, ndërsa së paku në këtë vit nuk është diskutuar e as nuk është marrë kurrfarë vendimi në Kuvend për ato hapësira publike, trotuare etj, e për këtë unë kam edhe ankesa nga

qytetarët të cilët kanë kërkuar që të ngritët kjo çështje në Kuvend ngase disa prej tyre shohin si pengesa para lokaleve të tyre.

Lidhur me këtë propozim vendim, do të ishte mirë të jemi të informuar ne këshilltarët e Kuvendit se shfrytëzuesi i deritanishëm përkatësisht Banka Private e Biznesit a i ka kryer të gjitha obligimet në mënyrë që ne si Kuvend t'i vendosim disa kriterë sigurie me të cilat do të kishim më të lehtë inkasimin e mjeteve nga ofertuesit. Ne nuk jemi të informuar zyrtarisht sa kemi të hyra saktësisht prej secilës pronë në mënyrë që të jemi sa më të kujdesshëm në aspektin e kryerjes së obligimeve nga ana e qiramarrësve që pastaj mos të bie ajo barrë mbi ndokënd tjetër.

Pra edhe një herë zotëri Kryesues kërkoj nga ti që në mbledhjen e ardhshme të më mundësohet një regjistër i pronave Komunale në mënyrë që unë si kryesues i Komitetit për Planifikim Urban Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të jem në dijeni për të gjitha pronat publike komunale, pra këtë kërkesë e parashtroj me qëllimin më të mirë që prona të jepet në shfrytëzim në bazë të ligjit dhe që të krijohen të hyra.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, drejtori z. Abaz Llugaliu e sqaroi se ky lokal ka qenë i dhënë me qira dhe e ka përfunduar kontratën, ndërsa tani për të mos ndejtur zbrazët ai lokal ne duhet t'i zhvillojmë procedurat ligjore, ndërsa sot kemi të bëjmë vetëm me miratim të vendimit.

Çështja të cilën e ngriti z. Rafet Llapashtica, në mbledhjen e radhës, nëse mundet apo në mbledhjen tjetër, Drejtoria përkatëse të përgatit regjistrin e të gjitha pronave publike në mënyrë që t'i shikojmë ne si Kuvend dhe aty ku ka kërkesa t'i procedojmë që të mos rrinë bosh ato prona por të jepen me qira sepse mendoj se ka të interesuar sidomos për zhvillimin e bizneseve gjë e cila është edhe në interes të qytetarëve.

Sa i përket kërkesave dhe pyetjeve që keni si këshilltarë të Kuvendit, siç ishte rasti i z. Haki Rudari që bëri pyetje në lidhje me Arsimin, mund t'i ngitni në pikën të ndryshme, ndërsa drejtorët e Drejtorive duhet t'ju kthejnë përgjigje me shkrim atyre që kanë parashtruar kërkesa apo pyetje.

z. Kadri Avdiu, theksoi, ne do të mbështesim këtë propozim vendim sepse nuk kemi nevojë të lëmë atë lokal të pa shfrytëzuar, e mbështes atë që e tha edhe z. Rafet Llapashtica që të kemi një regjistër kadastral për pronat publike komunale, dhe për këtë kam një propozim konkret, ato prona të cilat janë zënë apo uzurpuar me vite dhe që janë bërë ndërtime të shtëpive dhe biznese në ato prona komunale, pasi të definohen ato prona dhe individët që i shfrytëzojnë ato, me një vendim të Kuvendit t'ju caktohet një pagesë - qira në mënyrë që të mos mendojnë ata persona që ajo pronë tash është bërë e tyre, pra do të ishte një argument i fuqishëm se ato prona janë në shfrytëzim, por do të ishte e nevojshme edhe për të ardhmen sepse Komuna do të kishte më të lehtë tjetërsimin e atyre pronave në të.

Pas votimit njëzëri u konstatua se u miratua ky propozim vendim

6. Propozimi i Vendimit për ngritjen e Komiteteve Konsultative
- Miratimi i vendimit për publikimin e konkursit

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në kuadër të vendimit për ngritjen e Komiteteve Konsultative është paraparë të miratohet edhe vendimi për publikim të konkursit, për këtë çështje kemi biseduar edhe me përfaqësuesin e OSBE-së i cili është prezent këtu sot, por edhe me ligj obligohemi që t'i kemi të themeluara këto Komitete, sa jam në dijeni ne edhe në mandatin e kaluar kemi themeluar me vendim të Kuvendit këto Komitete por nuk kemi pasur të interesuar. Ne prapë do të publikojmë konkursin por mendoj se problem kryesor do të jetë pagesa – mëditjet që nuk parashihen për anëtarët e këtyre Komiteteve sepse nuk ka buxhet të mjaftueshëm për t'i kompensuar këta anëtarë mirëpo është në interes të Komunes të kemi të themeluara Komitetet Konsultative sepse ato komitete e ndihmojnë Kuvendin, kështu që besoj se të gjithë e keni të sqaruar këtë çështje, andaj e hedh në votim.

Pas votimit njëzëri u konstatua se u miratuan këto propozim vendime, përkatësisht Propozimi i Vendimit për ngritjen e Komiteteve Konsultative dhe Vendimi për publikimin e konkursit

7. Propozimi i Vendimit për Zëvendësimin e një anëtari të komisionit vlerësues për dhënien e pronave të Komunes në shfrytëzim

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në këtë pikë të rendit të ditës kemi të bëjmë me zëvendësimin e një anëtari nga radhët e subjektit politik LDK, konkretisht për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i cili ka qenë këshilltarë i Kuvendit dhe anëtarë i komisionit vlerësues për dhënien e pronave të Komunes në shfrytëzim, por meqë është emëruar në pozitën e drejtorit të cekur nuk ka të drejtë ligjore të jetë edhe anëtar i këtij komisioni, andaj kërkoj nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së të propozojnë një anëtar. Ne para fillimit të kësaj mbledhje patëm një konsultim dhe u propozua z. Afrim Shabani, nëse jeni në dakord ne hedhim në votim.

Pas votimit njëzëri u konstatua se u miratua ky propozim vendim, përkatësisht z. Agron Hyseni, ish anëtar i komisionit vlerësues për dhënien e pronave të Komunes në shfrytëzim, zëvendësohet me z. Afrim Shabani

8. Propozimi i vendimeve për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (sipas kërkesave të Besim, Vllaznim e Mustafë Ejupit – Gllamnik, Ajet Malokut – Bradash, Këshillit të Bashkësisë Islame – Podujevë, Sabit Selmanit – Gllamnik, Rexhep Cahanaj – Kraj, Zymer Duriqit – Obranqë, Armend Fejzullahut – Sallabajë, Bekim Havollit – Llapashticë e Epërme, Sabit Halitit – Podujevë dhe Fadil Bunjakut – Sallabajë).

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kemi dhjetë kërkesa për t'i miratuar, ne mund të votojmë për të gjitha në tërësi por mundemi edhe një nga një, andaj si të dëshironi ju. Sa për sqarim, për të mos vepruar në kundërshtim me ligjin, neni përkatës e

parasheh që edhe pse merret vendim nga Kuvendi i Komunës ku prej klasës I deri IV patjetër duhet të jepet edhe pëlqimi nga Ministria përkatëse e cila ka të ngritur një komision enkas për këto raste, ndërsa nga klasa e V-të e tutje vetëm me vendim të Kuvendit mund të destinohet toka. Kështu që ne, shumicën e këtyre kërkesave i kemi nën Klasën e V-të gjë që edhe pse ne marrim vendim sot, ai vendim nuk është i plotfuqishëm derisa sa të jepet pëlqimi nga Ministria.

z. Kadri Avdiu, theksoi, Kryesuesi e tha se nga klasa e V-të e tutje për destinim të tokës është në kompetencë të Kuvendit, mendoj se Drejtoria përkatëse posa t'i pranon këto kërkesa duhet që fillimisht të kërkon nga Ministria gjegjëse se a lejohet destinimi i atyre tokave, pastaj ne si Kuvend mund të marrim vendime, pra ne nuk jemi kundër destimit të tokave sepse ata persona kërkojnë të zhvillojnë ato toka, por duhet të mësohemi që vetëm t'i përfillim procedurat dhe të mos ndodhë që të bëjmë gabime ligjore që do të na ndodhte të miratojmë vendime të cilat pastaj nuk do të jepej pëlqimi nga niveli Qendrorë, e them këtë ngase ne kemi pasur në këtë vit raste të tilla ku ne kemi marr vendim në Kuvend ndërsa nga Ministria nuk i'u ka jap pëlqimi dhe më nuk ka ardhur në Kuvend ajo kërkesë, pra dua të them, të mësohemi t'i respektojmë rregullat dhe procedurat, dhe mendoj se më mirë është që atyre personave t'iu vonohet një apo dy muaj, se sa të merr Kuvendi vendim i cili do të mund të jetë i paligjshëm, andaj konsideroj se ne po miratojmë diçka pa pasur as një argument me dokumente para vetës.

z. Mirsad Kamerolli, theksoi, kërkoj që këto kërkesa të qytetarëve të miratohen pa asnjë hezitim në mënyrë që t'jua lehtësojmë procedurat sepse është një procedurë jashtëzakonisht e koklavitur. Unë kam pasur rastin të merrem me këtë çështje dhe kam qenë në konsultim të vazhdueshëm me Zyrën ligjore të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ku në atë Ministri ka një konfuzitet sa i përket trajtimit të këtyre çështjeve. Ligji e parasheh që për klasën I deri në të IV së pari Ministria duhet të jap pëlqim e pastaj vendimi duhet të miratohet në Kuvend, mirëpo ndërkohë është ndryshuar kjo rregull pa nxjerrur akte nënligjore përcjellëse nga ana e Ministrisë por vetëm është nxjerr një Udhëzim Administrativ ose vetëm është bërë ndonjë marrëveshje brenda institucionit përkatës në mënyrë që të heqin përgjegjësitë e tyre dhe ato t'i bartin në Kuvendet Komunale.

Më e rëndësishmja është që këta qytetarë të cilët kanë bërë kërkesa ku shumicën prej tyre i njoh personalisht, janë duke pritur që dy muaj që Kuvendi të miratoj kërkesat e tyre për shkak se drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit me qëllim nuk i ka proceduar për Kuvend për arsye se këto kërkesa i ka dërguar në Ministri për pëlqim nga ana e saj, mirëpo posa është kthyer përgjigje me shkrim nga Ministria, menjëherë janë proceduar në Kuvend. Andaj mendoj se nuk është mirë ne si Kuvend që ti lëmë qytetarët të presin edhe më shumë për këto vendime, por Drejtoria e Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit dhe Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e kanë për obligim që në secilën ngastër kadastrale në bazë të secilës kërkesë të caktojnë se cilës klasë i takon toka përkatëse në mënyrë që të mos humbin kohë qytetarët duke pyetur se cilës klasë i takon toka e tyre, dhe çështje tjetër e rëndësishme është se në qoftë se toka për të cilën bëhet kërkesa për destinim është e përfshirë në Planin Zhvillimorë Komunal, nuk ka nevojë të procedohet.

z. Naim Çunaku, theksoi, në parim i mbështesë të gjitha këto kërkesa sepse është e drejtë e çdo njërit që të shfrytëzoj pronën e vetë ashtu siç mendon ai, qoftë si tokë ndërtimore qoftë si tokë bujqësore, dhe mbështesë vullnetin e çdo kujt që dëshiron të bëjë ridestinimin e tokës. Kryesuesi bëri mirë që e sqaroi këtë sepse ne deri më tani kemi qenë në dijeni se së pari duhet të jepet pëlqimi nga Ministria përkatëse, dhe se qenkan dy nene të cilat e rregullojnë këtë çështje andaj do të ishte mirë që gjatë përgatitjes së dokumentacioneve për destinimin e tokës bujqësore të thirremi në nenin i cili na e mundëson paraprakisht neve si Kuvend të marrim vendim për ridestinim të tokës.

z. Vezir Januzi, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, theksoi, dëgjova me vëmendje disa mendime që i dhanë për Udhëzimin Administrativ përkatës e që ndoshta nuk ju takon të flasin për atë. Udhëzimi Administrativ 05/2006 e përcakton shumë qartë se si janë procedurat dhe si bëhet ndërrimi i destinimit të tokave bujqësore në toka ndërtimore ku për klasën I deri në IV thuhet se pëlqimi merret paraprakisht në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, edhe pse në dy nene përmenden Kuvendi i Komunës dhe Ministria përkatëse, unë mendoj që për klasën I deri në IV duhet të merret paraprakisht pëlqimi në Ministri, e them këtë ngase i kemi dy raste për të cilat është marrë vendim në këtë Kuvend për klasën e V-të, të cilat kanë shkuar në Ministri dhe që një muaj palët presin përgjigje nga Ministria. Ne si Drejtori kërkojmë që tokat prej klasës së I deri në IV të ndërrohen vetëm për veprimtari bujqësore, sepse mendoj që për veprimtari tjera të mos lëshohen ngase sipas statistikave thuhet që në çdo vit në Kosovë rreth 2000 hektarë tokë bujqësore bëhen ndërtime, pra e kërkoja këtë ngase mendoj se është mirë t'i mbrojmë tokat bujqësore.

Pra edhe një herë dua të sqaroj, qartë thuhet se pala paraprakisht duhet të bënë kërkesë në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe pasi të merr pëlqimin nga kjo Ministri pala duhet të bëjë kërkesë Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit e cila është e obliguar të procedoj në Kuvend për miratim të kërkesës, e nëse Kuvendi e miraton, atëherë kemi procedura tjera për shëndërrim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore nga ana Drejtorisë.

Kemi edhe shmangie të përgjegjësiave nga ana e Ministrisë, por konkretisht unë kërkoj që mos të lëshohemi në ndërrim të destinimit të tokave prej klasës së I deri në IV pa pasur pëlqim paraprak nga Ministria.

z. Naim Çunaku, theksoi, mora fjalën me qëllim ta kundërshtoj drejtorin parafolës i cili profesion e ka sferën e bujqësisë, i nderuar drejtor, anë profesionale, defekt profesional ose përparësi profesionale e ke që ta mbrosh pronën bujqësore dhe është e drejtë e jotja. Mirëpo nuk mbrohet toka bujqësore me arsyetim se nuk duhet të preket ajo tokë apo nuk po zvoglohet numri i tokave bujqësore, këtë e them duke u nisur prej një shembulli të cilin dua të ilustroj, unë vi nga fshati Lluga, fshat në të cilin ka vetëm tokë të klasës së I dhe II, dhe kam nevojë për zgjerim të objektit të banimit, atëherë si të zgjidhë problemin tim, dhe në këtë kontekst nuk kemi kurrfarë Plani as nga niveli Qendror e as nga Komuna. Pra ne vetëm mund t'ia vështirësojmë punët atyre të cilët dëshirojnë të ndërtojnë sepse nuk mbrohet toka bujqësore me fjalë.

Sqarimi i Kryesuesit të Kuvendit ishte më i arsyeshëm se sa tani që bëri këtë sqarim drejtori parafolës, sepse Kryesuesi në një formë tha se kemi dy nene dhe mund të thirremi në cilin dëshirojmë ne, ndërsa drejtori e tha se së pari duhet të kemi pëlqimin nga Ministria. tani kemi kaluar në situatën të cilën ne si Kuvend nuk kemi të drejtë të marrim

vendim për destinim të tokës nëse ajo tokë është nën klasën e IV, dhe tani ne si këshilltarë kemi konfuzion se a duhet apo nuk duhet të votojmë për këto kërkesa.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, dua të ndërlidhem me diskutimin e z. Vezir Januzi, drejtori i DBPZHR, dhe pajtohem shumë fuqishëm për atë që e tha, sepse ne ndoshta do të jemi shumë përgjegjës para gjeneratave që vijnë të cilëve ne po u'a mohojmë të drejtën e ekzistencës, drejtori e tha se rreth 2000 hektarë, në vit, tokë bujqësore tjetërsohen në tokë ndërtimore, ndërsa unë jam në dijeni se për çdo vit 1000 hektar tokë buke tjetërsohen në ndërtim, dhe cila do që të jetë mendoj se është krim për ekzistencën fizike, mirëpo mundemi ne të ndalojmë këtë vetëm duke bërë thirrje publike, mendoj se jo.

I nderua drejtor i Drejtorisë je pjesë edhe e Ekzekutivit të Komunës, a i keni diskutuar ndonjëherë që këto gjëra të ndalohen, që një banor i ndonjë fshati për të mos ndërtuar fermë në klasë të I-rë të tokës, të caktohen zonat industriale, zonat ekologjike dhe zonat e lira ekonomike, këtë me siguri se nuk e keni bërë asnjëherë, pra këto janë forma të tilla që mund të ndalin ndërtimin në toka bujqësore duke i shëndrruar ato në toka ndërtimore, prandaj qytetarët në mungesë të këtyre hapësirave, i bëjnë në hapësira e veta, dhe unë do të mbështetsha fuqishëm nëse ne përcaktohem i njëherë e mirë që zonat të cilat janë të dobëta për kah klasa i tyre, t'i orientojmë në zhvillime, ndërsa zonat që janë për bujqësi, klasa i I-rë dhe i II-të të ruhen, mirëpo këto gjëra duhet të ndodhin me ide dhe me Plan, apo fundja t'i ndalojmë.

z. Mirsad Kamerolli, theksoi, kam pasur rastin të takohem dhe të bisedoj me dy prej parashtruesve të kërkesave, procedurat janë të komplikuar për persona të cilët nuk janë me profesion të kësaj lëmie, z. Bekim Havolli nga fshati Gllamnik, ka bërë kërkesë për shëndrrim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, dhe përreth gjithë asaj parcele që ka bërë kërkesë është ndërtim, andaj nëse ne si Kuvend nuk votojmë për ndërrim të destinimit të tokës që ka bërë ai person, konsideroj se i bëhet e padrejtë, apo edhe parashtruesi tjetër z. Armend Fejzullahu nga fshati Sallabajë.

Gjithashtu kam pasur edhe takim me Zëvendësministrin e Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimi Rural dhe me nivele tjera në kuadër të Ministrisë, ata në fakt më nuk e marrin atë të drejtë por vetëm ne si Kuvend në qoftë se marrim vendim, atëherë Ministria obligohet që përmes komisionit i cili do të vlerëson gjendjen në terren dhe pastaj në bazë të konstatimeve të komisionit Ministria jep pëlqimin formal, për klasën e I deri në IV është fjala, komisioni është i përbërë vetëm prej katër personave dhe vepron në tërë territorin e Kosovës, kështu që këtyre qytetarëve do t'iu bie të presin edhe më gjatë deri sa të marrin pëlqimin përkatës nga ana e Ministrisë, andaj do të ishte mirë që ne sot të votojmë për këto kërkesa në mënyrë që t'iu bëhet më e lehtë puna këtyre qytetarëve.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratuan propozim vendimet, përkatësisht:

Propozim vendimi sipas kërkesës së Besim, Vllaznim e Mustafë Ejupit nga fshati Gllamnik,

Propozim vendimi sipas kërkesës së Ajet Malokut nga fshati Bradash,

Propozim vendimi sipas kërkesës së Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë,

Propozim vendimi sipas kërkesës së Sabit Selmanit nga fshati Gllamnik,

Propozim vendimi sipas kërkesës së Rexhep Cahanaj nga fshati Krajë,

Propozim vendimi sipas kërkesës së Zymer Duriqit nga fshati Obranqë,

Propozim vendimi sipas kërkesës së Armend Fejzullahut nga fshati Sallabajë,

*Propozim vendimi sipas kërkesës së Bekim Havollit nga fshati Llapashticë e Epërme,
Propozim vendimi sipas kërkesës së Sabit Halitit nga Podujevë, dhe
Propozim vendimi sipas kërkesës së Fadil Bunjakut nga fshati Sallabajë.*

9. Propozimi i Vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurt të pronës së paluajtshme të Komunës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë pikë e cila hyri në rend dite për këtë mbledhje, në fillim vërejta disa rezerva nga disa këshilltarë dhe Grupe të këshilltarëve, andaj nëse pajtoheni tani mund të debatojmë për këtë pikë, por mundemi edhe vetëm të votojmë ngase ky propozim vendim është vetëm paraprak sepse ka edhe procedura tjera deri në finalizim të tij. Pra deri te nënshkrimi i kontratës duhet të përfillen të gjitha procedurat ligjore.

z. Naim Çunaku, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhë e Partisë Demokratike të Kosovës votuam kundër hyrjes dhe formës si hyri në rend dite të kjo pike, do të votojmë dhe jemi kundër që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Jam në dijeni se janë edhe disa faza dhe procedura tjera, mirëpo unë e përsëris se konsideroj se është bërë shkelje ligjore prandaj edhe jemi kundër.

Pas votimit u konstatua se me 17 vota për, 14 vota kundër dhe 1 votë të përmbajtur u miratua ky propozim vendim

10. Të ndryshme

z. Adelinë Stublla, theksoi, meqë jemi në përfundim të vitit shkollor dhe kohëve të fundit ka qenë aktuale mbajtja e mbrëmjeve të maturës, andaj dëshiroj të ngriti këtë çështje para Kuvendit dhe kamë pyetje për Kryetarin e Komunës dhe drejtorin e Drejtorisë së Arsimit.

1- Sa shkolla të qyteteve të Kosovës e mbajnë mbrëmjen e maturës në lokalet hoteliere të Komunës tonë, dhe a ka ndodh ndonjëherë të vijnë tek ne.

2- Sa shkolla të qyteteve tjera vijnë në ekskursion në territorin e Komunës tonë, kur dihet se në territorin e Komunës tonë ka dhjetëra e dhjetëra lokale hoteliere me kapacitet të mjaftueshëm për organizimin e mbrëmjeve të tilla. Gjithashtu vendi ynë ka bukuri të rralla natyrore si, Liqenin e Batllavës ku në atë pjesë gjendet edhe Kulla e Heroit Zahir Pajaziti, e shumë e shumë bukuri të tjera që ju nuk ju keni bërë publicitet e aq më pak investime në infrastrukturën e këtyre vendeve.

Organizimi i dërgimit të nxënësve jashtë territorit të Komunës me autobus përveç çështjes së sigurisë dhe kthimit të tyre në orët e hershme të mëngjesit dhe që dihet se shumica janë femra nga vendet rurale me të cilat mund të ndodhin abuzime të ndryshme, pastaj çmimi tejet i lartë ku dihet se përqindja e të papunëve është e lartë.

E tërë kjo lë hapësirë për dyshime dhe pazarllëqe, andaj kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit të jap raportin e detajuar të shpenzimeve qoftë të udhëtimit vajtje ardhje, të ushqimit etj. E them këtë ngase mungon transparenca dhe lë vend për dyshime dhe të gjitha këto që i thash janë kërkesa dhe ankesa të cilat kanë ardhur në selinë tonë

Vetëvendosje nga ana e prindërve. Pastaj çështja e ekskursioneve ilegale që rrezikon fëmijët apo të afërmit tanë.

Meqë jemi duke biseduar për bizneset të cilat veprojnë në Komunën e Podujevës, jo që nuk po përkrahen ato biznese por atyre u janë vu edhe taksa vjetore për dallim nga Komunitet tjerë të cilat e kanë eliminuar kaheerë këtë çështje, pra fjala është për Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtori e cila i ngarkon bizneset me taksa komunale vjetore, andaj, propozoj të hiqen këto taksa dhe të amnistohen të gjitha ato biznese të cilat janë me borxhe të tilla, për shkak se nuk janë ndihmuar asnjëherë siç e ceka më parë në raste me mbrëmje të maturës apo me ahengje të ndryshme festive.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, mora fjalën me qëllim që t'i ngriti dy çështje, e para ndërlidhet me këtë që parafolësja e tha rreth mbrëmjeve të maturës për të cilën kam pyetje, sa ka qenë çmimi në këtë vit për nxënës për mbrëmje të maturës dhe a ka pasur oferta nga bizneset lokale hoteliere dhe sa ka qenë oferta e tyre, për këtë kërkoj përgjigje në mbledhjen e ardhshme.

Çështja e dytë, Ligji për Ndërmarrjet Publike, Komuna e Podujevës ka tri Ndërmarrje Publike me 100% aksione të veta, ato janë Ndërmarrja Banesore, Tregut dhe Stacioni i Autobusëve, andaj në mbledhjen e radhës kërkoj informacion se sa kemi të hyra nga këto Ndërmarrje, kush i menaxhon ato dhe cilat borde janë përgjegjëse për këto Ndërmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10'

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr. 01-006-50514
Podujevë,
27 maj 2014

Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi